

Projekti "**Ndihmë e mëtejshme për zhvillimin e tregtisë në Kosovë**" financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga GFA Consulting Group GmbH, Zyra e Patentave dhe Markave Tregtare në Danimarkë, Instituti Evropian për Politika Publike dhe WTI Advisors LTD.

Objektivi i përgjithshëm i projektit është të promovojë edhe më tej integrimin e Kosovës në ekonominë botërore dhe të fuqizojë rolin e shtetit në qeverisjen ekonomike përmes funksioneve rregullatore efektive në përputhje me obligimet që dalin nga MSA-ja.

Qëllimi i projektit është mbështetja e qeverisë së Kosovës në zhvillimin e mëtejshëm të kapaciteteve të saj institucionale për të krijuar bazën për një mjedis të qëndrueshëm për zhvillimin e sektorit privat në përputhje me acquis-in e BE-së dhe kërkesat që dalin nga MSA-ja.

Projekti përbëhet nga katër komponentë:

Komponenti 1: Marrëveshjet tregtare

Komponenti 2: Politika tregtare

Komponenti 3: Vlerësimi i ndikimit

Komponenti 4: Të drejtat e pronësisë industriale

Rezultatet:

Rritja e kapaciteteve të Qeverisë së Kosovës për të zhvilluar, negociuar dhe zbatuar politikën tregtare, duke përfshirë këtu edhe mbrojtjen dhe zbatimin e pronësisë intelektuale, në përputhje me kërkesat ndërkombëtare të tregtisë dhe praktikave të BE-së, si dhe përmirësimi i kapaciteteve të saj për t'i mbështetur tregtarët eksportues/importues nga Kosova.